



Bordi i Përbashkët Koordinues për sundimin e Ligjit

E mërkurë, 22 janar, 2014

14:00 – 16:00

Ndërtesa Kryesore e Qeverisë, kati i parë, salla P-38

KONKLUZIONE TË PËRBASHKËTA

Pjesëmarrësit

Kryesuesit:

Hajredin Kuçi (Zëvendëskryeminister dhe Minister i Drejtësisë); Samuel Žbogar (Shef i Zyrës së BE- së/ Përfaqësuesit Special i BE-së ; Bernd Borchardt (Shef i Misionit të EULEX-it);

Anëtarët dhe Anëtarët e Asociuar:

Bajram Rexhepi (Ministër i Punëve të Brendshme), Ismet Kabashi (Kryeprokurori i Shtetit); Fejzullah Hasani (Kryetar i Gjykatës Supreme), Gëzim Kasapolli (zëvendës ministri për Integritet Evropian); Joelle Vachter (Zëvendës Shef i Misionit, EULEX); Thomas Muehlmann (Shefi i Stafit), Peter Bach (Shef i Divizionit të perforcimit); Mats Mattsson (Shef i Divizionit Ekzekutiv);

Vëzhguesit:

Bryan Marcus (ud Zëvendës Shef i Seksionit Politik dhe Ekonomik), Laura Salihu, (Këshilltare për sundimin e ligjit).

Pjesëmarrës të tjerë:

- Shemi Hajrizi (ud Komisioner i Shërbimit Korrektues të Kosovës); Arsim Gerxhaliu (Drejtor i Departamentit të Mjekësisë Ligjore), Taulant Kryeziu, (Këshilltar i Lartë Politik i Ministrisë për Integritet Evropian), Venera Kabashi (Këshilltare Ligjore e Zëvendës Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë); Dafina Buçaj (Këshilltare ligjore e CDF te Zëvendës Kryeministri dhe Ministri i Drejtësisë), Jehona Lushaku (Këshilltare ligjore CDF-se te Zëvendës Kryeministri dhe Ministri i Drejtësisë);



- Jaroslava Novotna (KryeProkurore e EULEX-it), Jonathan Ratel (Shef i PSRK-së); Marjana Papa (asistente speciale e SHM); Ismije Beqiri (ud Shefe e Zyrës Politike dhe Gazetarisë), Vlora Marmullakaj (Zyrtare e Lartë -Anti-Korrupsion); Marko Hokkanen (Këshilltar në Menaxhimin Ekonomik), Alan Robinson (bashkryesyes i Departamentit të Mjekësisë Ligjore); Otto Rohde (Shef i zyrës Planifikimit, Koordinimit dhe Pajtueshmërisë); Alessandro Tedesco (Menaxher i Programit); Tihana Leko (Zyrtare e Vlerësimit të Programit).
- Christof Stock (Shef i Operacioneve, Zyra e BE-së); Andrew Powell (Këshilltar Ligjor / Politik, Ekonomik dhe Sektorit të integritimit Evropian); Karin Marmsoler (Këshilltare e Politikës); dhe Yvonne Gogoll (Udhëheqës Ekipi /seksioni i Operacioneve), Behlul Zeka (Zyrtar Ligjor / politik, ekonomik dhe i Integritimit Evropian).

1. Raporti mbi progresin e marreveshejs se kompaktit: njoftimet e radhes

BPBSL ka renë dakord për hartimin dhe publikimin e Raportit të dytë të Progresit të marreveshjes se kompaktit .BPBSL kërkoi nga Sekretariati i BPBSL për të koordinuar punën e ngarkuar dhe ekspertët përkatës për të siguruar të dhëna të nevojshme për një raport të tillë për miratimin dhe publikimin në mbledhjen e tij të ardhshëm të BPBSL.

2. Ndryshimet ligjore të AKP-së / KKPK-së Sugjerimet

BPBSL mori parasysh sugjerimet mbi ndryshimet ligjore për KPA / KKPK-së të paraqitura nga EULEX-i. Shefi i Misionit EULEX, Borchardt deklaroi se jo të gjitha sugjerimet e EULEX-it janë përfshirë në draftin përfundimtar. BPBSL u dakordua që të formohet një grup pune për të takuar brenda një jave për të punuar në harmonizimin e projektligjit përfundimtar dhe një linjë me sugjerime të EULEX-it dhe në pajtim me ligjet në fuqi. QeK, ZBE dhe EULEX-it i është kërkuar që të emërojnë anëtarët e grupit të punës brenda tri ditëve të punës.

3. Te arriturat ne fushen e Anti-korrupsion – gjendja e tanishme

Shefi i Misionit EULEX, Borchardt ka prezantuar matricën e standardeve kundër korrupsionit e cila është hartuar në bazë të kontributit të marre nga institucionet e Kosovës. BPBSL vuri në dukje nevojën për matricën për të pasur të dhëna më konkrete. BPBSL ka miratuar këtë matricë dhe ranë dakord të ngrisin një grup pune që do të përbëhet nga tre anëtarë nga institucionet e Kosovës dhe tre anëtarëve të EULEX-it. Grupi i punës duhet të jetë i përbërë brenda 7 ditëve nga mbledhja e BPBSL. Ai do të jetë përgjegjës për të rinovuar matricën dhe ta paraqesë atë 10 ditë pune para mbledhjes së ardhshme të BPBSL.

4. Udhërrëfytes për Krimet e Luftës



BPBSL ka diskutuar dhe miratuar Udhërrëfyesin e hartuar bashkërisht për krimet e luftës. QK është angazhuar për të dedikuar burimet e nevojshme për zbatimin e Udhërrëfyesit. BPBSL ka vendosur të ngris një grup pune me ekspertë nga institucionet e Kosovës dhe EULEX-it, të cilët do të jenë përgjegjës për të shqyrtuar përparimin në zbatimin e udhërrëfyesit dhe të ofrojë një përditësim me shkrim 10 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së ardhshme të BPBSL-se. Qeveria e Kosovës dhe EULEX-i duhet të emërojnë anëtarët e grupit të punës brenda 7 ditëve nga konkluzioni i takimit të BPBSL-se. Grupi i punës do të kryesohet nga një anëtar i institucioneve të Kosovës.

5. Udhërrëfyesi për Mbrojtjen e Dëshmitarëve: Gjendja aktuale

Një raport nga shefi i Policisë së Kosovës, Maxhuni është ofruar në takimin e BPBSL. Të dy, Shefi i Misionit EULEX, Borchardt dhe Shefi i Zyrës BE / EUSR, Zbogar ka njohur progresin që është arritur në zbatimin e Udhërrëfyesit dhe tha se pronësia vendore po rritet çdo ditë. Kryesoret e BPBSL-se moren parasysh angazhimin e përtërirë të Qeverisë së Kosovës që të rrinë në premtimet e saj dhe të sigurojë, ndër të tjera, automjetet e nevojshme për punën e njësisë për mbrojtjen e dëshmitarëve. BPBSL theksoi nevojën për të shtyrë përpara me zbatimin e udhërrëfyesit në këtë fushë shumë të ndjeshme dhe të rëndësishme për sundimin e ligjit. Ajo ftoi PK, ZBE dhe EULEX-in që të mbajë lidhje të ngushtë për të rënë dakord për hapat e mëtejshëm që do të merren me qëllim të përmbushjes së udhërrëfyesit plotësisht.

BPBSL kërkoi një raport me shkrim të përditësuar për të e paraqitur sërish, në mbledhjen e ardhshme të BPBSL.

6. Udhërrëfyesi për percjelljen e të burgosurve në pjesën veriore të Mitrovicës - gjendja dhe çështjet e lidhura buxhetore lidhur me Burgun e Sigurisë së Lartë

BPBSL mori parasysh progresin e bërë në zbatimin e Udhërrëfyesit, si dhe një raport lidhur me çështjet buxhetore për Burgun e Sigurisë së Lartë. QK informoi pjesëmarrësit e takimit me planet e tyre për të kapërcyer sfidat aktuale dhe angazhimin për të dedikuar të gjitha burimet e nevojshme në mënyrë që të bëjë BSL plotësisht operacional, duke përfshirë punësimin e stafit që është në proces. Në veçanti, Qeveria e Kosovës do të konfirmojë percjelljet e para të burgosurve që do të behen nga Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe kur të gjitha percjelljet do të merren në përgjegjësi. BPBSL ka pritur për të marrë një afat kohor të dakorduar të ri dhe standardeve sasiore në përputhje me skemën e punës brenda dy javësh. BPBSL ka kërkuar një përditësim me shkrim mbi këto çështje 10 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së ardhshme të BPBSL. BPBSL ka diskutuar situatën buxhetore të Burgut të Sigurisë së Lartë. Ai mori parasysh angazhimin e Qeverisë së Kosovës për dhenjen e burimeve të mjaftueshme dhe në kohen e duhur BSL -se dhe pret një përditësim që do të ofrohet nga QK në mbledhjen e ardhshme.

7. Udhërrëfyesi për Panelin e Ankesave të Agjencionit Kosovar të Pronës: Gjendja aktuale



KGJK-ja paraqiti një përditësim mbi zbatimin e Udhërrëfyesit. Shefi i Misionit të EULEX-it, Borchardt theksoi nevojën për rekrutim shtesë të gjyqtarëve vendor dhe stafin mbeshtetes në mënyrë që të krijojnë Panelin e dyte të apelit të AKP-së. KGJK-ja raportoi se ata janë në proces të rekrutimit të gjyqtarëve shtesë dhe se ky proces ka të ngjarë të përfundojë brenda dy deri tre muaj. BPBSL ka ngarkuar Sekretariatit të BPBSL për të ndjekur me KGJK-në afatet kohore të parapara për konkuret e shpallura dhe gjendjen e tanishme të procesit të përzgjedhjes, dhe të raportojë tek kryesoret e BSPL-se në bazë të rregullt .BPBSL ka shprehur shpresën se udhërrëfyesi do të zbatohet plotësisht, edhe në qoftë se vonohet, përpara takimit të saj të ardhshëm. BPBSL shprehu me shqetësim vonesa serioze në implementimin e udhërrëfyesit, të cilat do të kenë ndikim në afatet kohore të parapara për të përfunduar punën e AKP-së, dhe kerkoi nga KGJK-, në koordinim me Kryetarin e Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, raport me shkrim për Zbatimin e Udhërrëfyesit 10 ditë para mbajtjes së takimit të ardhshëm BPBSL-se.

8. Udhërrëfyesi për Departamentin e Mjekësisë Ligjore: Gjendja e tanishme

Shefi i DML paraqiti një raport mbi zbatimin e Udhërrëfyesit dhe paraqiti sfidat në përmbushjen e rekrutimit të personelit shtesë të nevojshëm në këtë Departament. BPBSL Vuri në dukje me shqetësim se zbatimi i udhërrëfyesit ka filluar me vështirësi filluar dhe ka kërkuar nga të dy bashkëkryesuesit të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të sjellë zbatimin e udhërrëfyesit në rrugën e duhur. QeK është angazhuar për të dërguar vlerësimin e nevojave dhe projektligjin për krijimin e Agjencisë për Mjekësi Ligjore për të gjitha palët e interesuara për komente nga mesi i shkurtit. Ajo gjithashtu i kerkoi DML që të paraqesë, nëpërmjet Sekretariatit BPBSL, brenda një jave një plan për të siguruar burimet e nevojshme njerëzore. BPBSL ka kërkuar edhe një raport me shkrim për Implementimin e Udhërrëfyesit 10 ditë para mbajtjes së takimit të ardhshëm të BPBSL-se duke theksuar që Përmbushja e udhërrëfyesit është një faktor i rëndësishëm që do të lejojë largimin e ngadalshëm të EULEX-it në këto fushë të rëndësishme të sundimit të ligjit.

9. Udhërrëfyesi për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme: Gjendja aktuale

Kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullahu, paraqiti raportin e Gjendjes së tanishme mbi këtë çështje. BPBSL mori parasysh progresin e bërë në zbatimin e Udhërrëfyesit, diskutuan hapat e ardhshëm dhe Vune në dukje me shqetësim që dy gjyqtarët shtesë ende nuk janë rekrutuar në përputhje me udhërrëfyesin. Ai kërkoj nga KGJK- te dyfishojnë përpjekjet për të përmbushur kërkesat e burimeve njerëzore të udhërrëfyesit dhe moren parasysh njoftimin e KGJK-së se të dy gjyqtarët shtesë do të emërohen përpara fundit të marsit. BPBSL ngarkoi Sekretariatit të BPBSL për të ndjekur me KGJK-në emërimet dhe të raportojnë tek kryesoret e BPBSL në bazë të rregullt . BPBSL i kërkoj Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në koordinim me Kryetarin e Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, të sigurojnë një tjetër raport me shkrim për Implementimin e Udhërrëfyesit 10 ditë para mbajtjes së takimit të ardhshëm të BPBSL-se.

10. Zbatimi i Kompaktit: Rishikimi i progresit

BPBSL Shqyrtoi sfidat që kanë dale që nga takimi në shtator i BPBSL-se në një raport të gjendjes së tanishme të paraqitur nga Udhehqesi për performancën e EULEX-it, Bach.



Në vijim të diskutimeve në dialogun e strukturuar për sundimin e ligjit me 16 janar, BPBSL ka diskutuar çështjen e ndërhyrjes politike në fushën e sundimit të ligjit. Në veçanti ishin diskutuar pretendimi i ndërhyrjes politike në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe ndërhyrjes politike në gjyqësor .

BPBSL theksoi nevojën për të luftuar ndërhyrjen politike në sundimin e ligjit dhe mirepriti një jo-letër paraqitur nga EULEX-i. Ai ngarkoi Sekretariatit e BPBSL, të mbështetur nga ekspertët, për të zhvilluar atë më tej me qëllim për të miratuar një sërë masash në mbledhjen e ardhshme të BPBSL.

11. Marreveshja kompakt e Mekanizmit Përcjellës- gjendja e tanishme

Shefi i Misionit të EULEX-it prezantoi një raport mbi gjendjen e tanishme të marreveshjes kompakt të mekanizmit përcjellës . Të tre krerët e qe udhëheqen takimin e BPBSL Ranë dakord për hartimin e treguesve të ri dhe për të vazhduar punën në këtë drejtim. Treguesit e ri si dhe më të rejtat të nderlidhura , do të miratohen në takimin e ardhshëm të BPBSL. BPBSL ranë gjithashtu dakord se përditësimi i fundit i CTM nga shtatori do të publikohet në faqen e internetit të EULEX-it me të rënë dakord më parë. Çdo koment shtesë për këtë dokument do të duhet për të arritur në EULEX-in në krye të tri ditëve. Nën këtë temë, Shefi i Misionit EULEX ka ngritur disa nga çështjet e diskutuar të dialogut të strukturuar për sundimin të ligjit në Bruksel, janar 2014.

12. Shqyrtimi i propozimit të ZBE në çështjet pronësore ndëretnike

Në bazë të një kërkesë të ngritur nga EUSR (PSBE) në takim të BPBSL në shtator 2013, Mie ka organizuar takime të veçanta me Institucionet / agjencitë e perzgjedhura dhe synon të organizojë një takim të përbashkët me të gjitha palët e interesuara për të diskutuar përmbledhjen e OSBE-së për këtë çështje. Një raport do të hartohet për këtë çështje dhe të njëjtën gjë do të ndahet Me BPBSL në mbledhjen e ardhshme. Shefi i Misionit EULEX, Borchardt dhe Shefi i ZBE / EUSR, Zbogor dha mbështetje për institucionet e Kosovës dhe gatishmërinë e tyre dhe ka njohur vullnetin për të pasur pronësi(zotesi) mbi këtë çështje. BPBSL ka rënë dakord për të ngritur një panel të kryesuar nga Drejtori i AKP-se i cili do të raportoj rregullisht në BPBSL për çështjet pronësore ndëretnike .BPBSL ftoi drejtorin e AKP-se për të paraqitur një raport të parë të tillë në mbledhjen e tij të ardhshme.

13. Tranzicioni mbështetur nga IPA II (2014-2020): Gjendja e tanishme

Shefi i operacionit në ZBE, Stock, paraqiti raportin e gjendjes së tanishme në programimin e IPA II.